

TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.

**Pasqyrat Financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	(i)
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	6
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN, NETO	8
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	9
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	10 – 31

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtuesve të Shoqërisë Turgut Özal Education sh.a.,

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Turgut Özal Education Sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e fitim ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare më dhe për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të përshkruara në seksionin Baza për Opinionin me rezervë e këtij raporti, pasqyrat financiare të bashkëlidhura pasqyrojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, performancën financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur më këtë datë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për Opinion me rezervë

Mos pjesëmarrja në numërimin fizik të inventarit

Ne jemi caktuar si auditues të Shoqërisë në muajin janar të vitit 2018 dhe në këtë mënyrë nuk kemi vëzhguar numërimin fizik të inventarit në fillim dhe në fund të vitit. Proçedurat alternative nuk plotësuan kërkesat tona lidhur me sasinë e inventarit të mbajtura më 31 dhjetor 2017 dhe 2016. Meqënese teprica çelëse dhe mbyllëse e inventarit ndikon në përcaktimin e performancës financiare dhe flukseve monetare të Shoqërisë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim, nëse, veprimet rregulluese mund të kenë qenë të nevojshme lidhur me fitimin e vitit raportues dhe fitimin e paspërndarë të raportuara në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe në pasqyrën e pozicionit financiar dhe flukset neto monetare nga aktivitetet operative të pasqyruara në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare

Aktivet afat gjata materiale

Sikurse pasqyrohet në shënimin shpjegues nr. 4 të pasqyrave financiare, aktivet afatgjata materiale janë të raportuara me një vlerë prej Lek 2,202,450,067 më 31 dhjetor 2017 (2,2771,361,991 Lek: 31 dhjetor 2016). Shoqëria nuk disponon një regjistër të përshtatshëm të aktiveve afatgjata materiale siç kërkohet nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit nr.16 "Aktivet afatgjata materiale" dhe nuk ka kryer një inspektim fizik për të konfirmuar ekzistencën, kushtet fizike të aktiveve dhe plotësinë e vlerës së raportuar më 31 dhjetor 2017. Në mungesë të tyre, nuk ishim në gjendje të plotësonim kërkesat tona nëpërmjet proçedurave alternative për ekzistencën, plotësinë, saktësinë dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimit të zhvlerësimit të lidhur me to, të raportuara në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016. Meqënese teprica mbyllëse e aktiveve afatgjata materiale dhe e shpenzimit të zhvlerësimit ndikon në përcaktimin e performancës financiare dhe flukseve të monetare të Shoqërisë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim, nëse, veprimet rregulluese mund të kenë qenë të nevojshme lidhur me aktivet afatgjata materiale të pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar, fitimin për vitin raportues e pasqyruar në pasqyrën e Fitim ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe flukset monetare neto nga aktivitetet investuese dhe operative të pasqyruara në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017.

Baza për Opinion me rezervë (vazhdim)

Të ardhurat nga shërbimet

Siç pasqyrohet në shënimin shpjegues nr. 16 të pasqyrave financiare të ardhurat nga shërbimet janë të raportuara me një vlerë prej Lek 1,492,931,114 për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (Lek 1,461,298,271 për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016). Shoqëria njeh të ardhurat nga shitja e shërbimeve sipas flukseve monetare hyrëse sipas kësteve të përcaktuara në kontratën me klientët. Të ardhurat nuk janë të njohura sipas periudhës kohore në të cilën ofrohen shërbimet. Si rrjedhojë, të ardhurat nga shërbimet nuk njihen, maten dhe pasqyrohen sipas SNK 18 “Të ardhurat”, e cila kërkon, që njohja dhe matja e të ardhurave të bëhet sipas metodës së përqindjes së realizimit. Për arsye të mungesës së evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me stadin e përfundimit të shërbimit, nuk është e mundur të kuantifikojmë ndikimin e kësaj çështjeje në pasqyrat financiare bashkëlidhur. Meqënëse të ardhurat ndikojnë në fitimin e vitit, llogaritë e arkëtueshme, të ardhurat e shtyra dhe në flukset neto të mjeteve monetare nga aktivitetet operative, nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse veprimet rregulluese kanë qënë të nevojshme lidhur me fitimin e vitit, llogaritë e arkëtueshme dhe të ardhurat e shtyra të pasqyruara respektivisht në pasqyrën e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 dhe në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

Kemi përfunduar auditimin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISAs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë të përshkruara në seksionin e “Përgjegjësi të Audituesit” të këtij raporti, për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Jemi të pavarur nga Shoqëria sipas kërkesave të Kodit të Etikës e miratuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Ekspertët Kontabël dhe sipas kërkesave etike për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi plotësuar përgjegjësitë tona etike sipas këtyre kërkesave. Besojmë se evidencat e auditimit të marra gjatë procesit të auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur bazën për opinion me rezervë.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritjet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese, si dhe nëse transaksionet dhe ngjarjet në pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë të drejtë.
- Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.

Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji - Miniera,
Tiranë, Shqipëri

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H



Enida Cara
Partner Angazhimi
Audituesi ligjor

10 korrik 2018
Tiranë, Shqipëri

TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Aktivitet			
Aktivitet afatgjata			
Aktive afat gjata materiale	4	2,202,450,067	2,271,361,991
Aktive afat gjata jo material	5	368,029	4,838,267
Totali i Aktiveve afatgjata		2,202,818,096	2,276,200,258
Aktive afatshkurtra			
Inventar	6	19,021,513	13,405,028
Llogari te arkëtueshme	7	45,943,389	154,000
Të arkëtueshme të tjera	7	81,452,823	67,127,595
Hua ndaj palëve të treta	8	19,041,092	-
Tatim fitim i arkëtueshëm		-	16,470,974
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	9	31,913,820	23,121,426
Totali i aktiveve afatshkurtra		197,372,637	120,279,022
Totali i aktiveve		2,400,190,733	2,396,479,281
Detyrimet dhe kapitali			
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali aksionar	10	1,133,700,000	1,133,700,000
Rezerva të tjera	10	59,031,349	52,664,836
Fitime të pashpërndara	10	196,681,841	127,313,513
Totali i kapitalit		1,389,413,190	1,313,678,349
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjatë	11	639,768,874	796,196,424
Totali i detyrimeve afatgjata		639,768,874	796,196,424
Detyrime afatshkurtra			
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	11	223,603,106	145,456,028
Llogari të pagueshme	12	40,316,745	76,474,285
Të pagueshme të tjera	13	35,385,902	53,975,164
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	3,336,313	10,699,031
Tatim fitim i pagueshëm		14,027,384	-
Të ardhura të shtyra	14	54,339,219	-
Totali i detyrimeve afatgjata		371,008,669	286,604,508
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		2,400,190,733	2,396,479,281

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 10 deri më 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura			
Të ardhurat nga shërbimet	16	1,492,931,114	1,461,298,271
Të ardhura të tjera	17	204,332,900	208,383,129
Totali i të ardhurave		1,697,264,014	1,669,681,400
Shpenzime			
Shpenzime për personelin	18	(639,645,630)	(611,119,547)
Lendë e parë dhe mallra konsumi	19	(290,882,011)	(336,243,956)
Shpenzime karburanti dhe transporti	20	(98,382,641)	(81,564,049)
Shpenzime nga qiraja	21	(88,924,436)	(83,272,791)
Shpenzime shitjeje dhe marketing	22	(7,241,476)	(10,428,836)
Shpenzime për palë të treta		(27,789,269)	(27,827,927)
Shpenzime sigurie		(22,523,439)	(23,041,972)
Zhvlerësim dhe amortizim	4,5	(144,724,458)	(155,937,046)
Kosto financiare	23	(44,920,015)	(56,337,043)
Fitim/humbja nga kursi i këmbimit	24	11,592,155	(52,243,218)
Shpenzime të tjera	25	(111,031,213)	(81,405,389)
Totali i shpenzimeve		(1,464,472,433)	(1,519,421,775)
Fitim para tatimit		232,791,580	150,295,625
Shpenzimi i tatim fitimit	26	36,109,739	(22,946,113)
FITIM PER VITIN		196,681,841	127,313,513
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN		196,681,841	127,313,513

Pasqyra e fitim dhe humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 10 deri më 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndare	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	1,133,700,000	52,003,276	13,231,196	1,198,934,472
Fitimi i vitit	-	-	127,313,513	127,313,513
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	127,313,513	127,313,513
Transferimi i fitimit të pashpërndarë në rezerva të tjera	-	661,561	(661,561)	-
Shpërndarja e dividendit	-	-	(12,569,635)	(12,569,635)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,133,700,000	52,664,837	127,313,513	1,313,678,349
Fitimi i vitit	-	-	196,681,841	196,681,841
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	196,681,841	196,681,841
Transferimi i fitimit të pashpërndarë në rezerva të tjera	-	6,366,513	(6,366,513)	-
Shpërndarja e dividendit	-	-	(120,947,000)	(120,947,000)
Gjendje më 31 dhjetor 2017	1,133,700,000	59,031,350	196,681,841	1,389,413,190

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 10 deri më 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në 25 qershor 2018 dhe janë firmosur nga:

Gëzime Onat

Shefe kontabiliteti

Gëzime Onat



Mustafa Üstuner

Drejtor ekzekutiv

W

TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi para tatimit	232,791,580	150,259,625
Rregullime për:		
Shpenzime amortizimi	144,724,458	
Shpenzime interesi	43,851,153	155,937,046
Humbja e perealizuar nga kursi i këmbimit	1,397,539	52,683,104
Fitim nga shitja e aktiveve	4,218,793	52,664,836
Ndryshim në provigjon për inventarin e vjetëruar	400,265	-
Fitimi në aktivitetin operativ përpara ndryshimeve në kapitalin punues:	427,383,787	411,544,612
Rritje në llogaritë e arkëtueshme	(45,789,389)	(8,934,520)
Rritje në inventar	(6,016,749)	(261,643)
Rritje në llogari të arkëtueshme të tjera	(14,325,228)	-
Huadhënie palëve të treat	(19,041,092)	-
Rritje në llogaritë e pagueshme	(36,157,541)	(5,710,355)
Rritje në detyrime të tjera	(18,589,262)	(131,106,208)
Rritje në të ardhura të shtyra	54,339,219	-
Interesi i paguar	(43,851,153)	(52,683,104)
Tatim fitimi i paguar	(5,611,381)	(7,955,433)
Fluksi i mjeteve monetare neto e përdorur gjatë veprimtarisë së shfrytëzimit	292,341,212	204,893,349
Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e investimit		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(75,920,981)	(38,586,480)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	766,833	-
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	(406,940)	-
Fluksi i mjeteve monetare neto e përdorur në veprimtaritë e investimit	(75,561,088)	(38,586,480)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet financiare		
Pagesa e kredive afatgjata	(78,280,473)	(183,346,193)
Dividendët e paguar	(128,309,718)	(12,569,635)
Mjetet monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financiare	(206,590,191)	(195,915,828)
Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre	10,189,933	(29,433,650)
Efekt i kursit të këmbimit	(1,397,539)	(175,309)
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	23,121,426	52,730,385
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	31,913,820	23,121,426

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 10 deri më 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Turgut Özal Education sh.a. (në vijim referuar si "Shoqëria") është një Shoqëri arsimore e themeluar fillimisht më 21 maj 2001 si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "UFUK, Education & Publication Company", e cila është ndryshuar më vonë në "Turgut Ozal Education". Më 13 tetor 2011 Shoqëria ka ndryshuar formën e saj ligjore për një kompani të përbashkët të aksioneve dhe sigurimin e arsimit në të gjitha nivelet që në 2007-ën me hapjen e Universitetin Epoka.

Bazuar në eskraktin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të datës 25 qershor 2018 administrator i përgjithshëm i Shoqërisë është Z. Mustafa Üstuner.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është të përmbyshtë standardet dhe të ndjekë programet e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit pa ndonjë diskriminim politik, fetar, racor dhe gjinor. Institucioni ofron një edukim akademik të një niveli të lartësi një përgjigje ndaj kërkeses së studentëve dhe përgatitjen për një kariere të suksesshme.

Kapitali i Shoqërisë është Lek 1,133,700,000 e ndarë në mënyrë të barabartë në 1,133,700 aksione me një vlerë nominale prej Lek 1000 për aksion. Shoqëria zotërohet 100% nga Shoqëria mëmë BF Cooperatief U.A. e cila është e vendosur në Hollandë.

Adresa e Shoqërisë është Rr. "Pavaresia", Aut. Tirane - Durres Km.1 / Tirane.

Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria ka pasur 674 punonjës (2016: 651).

2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në përpushje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), mbi bazën e kostos historike. Pasqyrat Financiare të Shoqërisë janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, sipas së cilës Shoqëria do të vazhdojë të operojë dhe në periudhën raportuese në vazhdim.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, kërkon nga Drejtimi, që të bëhen vlerësime dhe gjykime kontabel. Elementët e pasqyrave financiare të cilat kërkojnë një nivel më të lartë gjykimi ose subjektivizëm dhe për të cilat supozimet dhe gjykimet kanë një influencë më të lartë, janë shpjeguar në shënimin shpjegues 3.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

3.1 Prezantimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Këto pasqyrat financiare janë të përgatitura në LEK, që është edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e raportimit. Asetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj janë të matura me koston historike, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet ose humbjet e rezultuara nga këto transaksione njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Njohja e të ardhurave

i. Të ardhura nga shitja e mallrave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë nga Shoqëria. Të ardhurat reduktohen për kthimet e vlerësuara të klientit, ulje dhe skonto. Të ardhurat do të njihen kur kemi prova për ekzistencën e tyre, zakonisht në formën e mallrave të dhëna ose shërbimeve të kryera ku rreziqet dhe përfitimet e lidhura me to janë transferuar nga shitësi të blerësi; mbledhja e të cilave është e mundshme; kostot e lidhura me to dhe kthimet e mundshme të produkteve dhe shërbimeve mund të maten në mënyrë të besueshme; nuk ka përfshirje të vazhdueshme menaxheriale në produktet dhe shërbimet dhe nëse shuma e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Nëse është e mundshme që zbritjet që do të jepen dhe shuma mund të matet me saktësi, atëherë zbritja njihet si ulje nga të ardhurat nga shitja, gjatë procesit të njohjes së të ardhurave. Koha e transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve varet nga kushte specifike gjatë procesit të shitjes.

ii. Shërbimet

Shoqëria i njeh të ardhura nga shitja e shërbimeve në pasqyrat financiare të fitimit ose humbjes mbi bazën e flukseve monetare hyrese të arketuara sipas skedulit të kësteve në kontratat e nënshkruara me klientet.

iii. Të ardhura nga interesi

E ardhura nga interesi përfaqësohet nga interesi mbi fondet e investuara në depozita dhe njihet në fitim ose humbje në bazë të parimit të kontabilitetit rritës duke përdorur metodën efektive të interesit.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Zëri i aktiveve afatgjata materiale është e matur me kosto historike duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto historike përfshin shpenzimet e lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Shpenzimet shitesë do të kapitalizohen në qoftë se nga përdorimi i tyre do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen dhe nëse shuma e tyre mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera të mirëmbajtjes dhe riparimit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në kohën kur ato ndodhin.

Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur duke shpërndarë koston e aktiveve afatgjata materiale përgjatë jetës së tyre të dobishme. Amortizimi fillon kur aktivi është në dispozicion për përdorim. Normat e amortizimit janë si më poshtë:

Kategoritë e aktiveve	Metoda	Përqindja / vit
Ndërtesa	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	5%
Pajisje zyre	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	25%
Makina	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%
Pajisje kompjuterike	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	25%
Të tjera	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktiveve rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Vlera kontabël neto do të ulet deri në vlerën e rikuperueshme nëse ajo tejkalon vlerën e mbetur të aktivitetit. Fitimi ose humbja neto që rrjedh nga shitja e një aktivi afatgjatë material njihet në zërin "Të ardhura të tjera operative" në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jo materiale të blera nga Shoqëria të cilat kanë një jetë të dobishme të përcaktuar, janë të praqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kosto shtesë

Kostot shtesë do të kapitalizohen në qoftë se nga përdorimi i tyre do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen. Të gjitha kostot e tjera, përfshirë shpenzime për emrin e mirë dhe markave të prodhuara do të njihen në pasqyrën e të ardhurave, kur ato ndodhin. Shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e softëare-ve kompjuterike njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet duke përdorur amortizimin linear mbi jetën e dobishme të aktivitet jo material që nga data e vënies në përdorim. Kostot e softëare-ve të njohura si aktiv do të amortizohen mbi vlerësimin e jetës së dobishme, e cila nuk është më shumë se 4 vjet. Jeta e dobishme rishikohet dhe rregullohet nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Fitimet dhe humjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një aktivitet jo-material maten si diferencë midis të ardhurës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël neto të aktivitet dhe njihen si fitime ose humbje.

Për të vlerësuar humbjen, Shoqëria përcakton grupin më të vogël të aktiveve të cilat gjenerojnë flukse të identifikueshme të mjeteve monetare (njësia gjeneruese e mjeteve monetare). Si rezultat, disa aktive vlerësohen për humbjen individualisht dhe disa të tjera përfshihen në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare.

3.6 Qira operative

Pagesat e bëra për qiranë operative njihen dhe regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve mbi një bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë. Skontot e marra nga qiradhënësi do të njihen si pjesë e pagesës totale të qirasë sipas termave të qirasë.

3.7 Inventari

Inventari matet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet bazuar në metodën FIFO dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes dhe kostove të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së inventarit në vendodhjen dhe gjendjen aktuale, duke përfshirë dhe koston e vulës së blerë nga Drejtoria e Doganave të Republikës së Shqipërisë lidhur me akcizën e produktit. Vlera neto e realizueshme është vlerësuar me çmimin e shitjes gjatë aktivitetit normal minus kostot e përfundimit dhe shpenzimeve të shitjes.

Inventari njihet fillimisht me kosto historike dhe në vijim vlerësohet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes për njësi e zvogëluar me kostot e ndryshueshme të shitjes. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën FIFO dhe përbëhet nga kosto e blerjeve dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta të lidhura me sjelljen e inventarin në gjendjen aktuale.

3.8 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në arkë dhe llogari rrjedhëse të mbajtura me kosto. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.9 Aktivitet financiar

Instrumentat financiarë të Shoqërisë gjatë 2017 përbëhen vetëm nga instrumenta financiarë joderivative: hua dhe të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre (ku përfshihen depozitat bankare të mbajtura deri në maturim) dhe të pagueshme të tjera. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë ose me koston e amortizuar, sipas klasifikimit të tyre.

3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.9 Aktivet financiare (vazhdim)

Njohja

Shoqëria fillimisht njihet të arkëtueshmet financiare, depozitat dhe llogaritë e investimeve në datën në të cilën janë krijuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Matja e mëvonshme

Të gjitha aktivet financiare do të jenë i rivlerësimeve pas njohjes së tyre në kontabilitet, të cilat do të maten me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë. Një matje e tillë është e zbatueshme për të gjitha aktivet dhe/ose detyrimet financiare. Në mënyrë të veçantë, për investimet e borxhit që i përkasin një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale të përbëra nga pagesa për principalin dhe interesin janë përgjithësisht të matura me koston e amortizuar në fund të periudhave raportuese. Instrumentat e borxhit që i përkasin një modeli biznesi objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare dhe shitja e aktiveve financiare, janë të matur në përgjithësi në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në arkë dhe llogari rrjedhëse të mbajtura me kosto. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbje nga rënia në vlerë. Llogaritë e arkëtueshme aftashkurta nuk skontojnë.

Huatë dhe llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen me vlerën e tyre të amortizuar.

(i) Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ekziston një tregues objektiv që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivitetit financiar.

Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të aktivitetit. Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim mbi bazë individuale. Aktivet e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

(ii) Çregjistrimi

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose kur transferon aktivitetin financiar në një transaksion në të cilën kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar transferohen. Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ose janë anulua

3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.9 Aktivet financiare (vazhdim)

(iii) *Kompensimi i instrumentave financiarë*

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen në shumën neto që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur, Shoqëria ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe nuk synon të vendosë mbi shlyerjen mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

(iv) *Vlera e drejtë*

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të arkëtueshme tregëtare dhe të tjera, të pagueshme tregëtare dhe të tjera janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël për shkak të termave të shkurtër të maturitetit.

3.10 Kontributet e sigurimeve shoqërore të detyrueshme

Një plan me kontribute të përcaktuara është një skemë përfitimi pas-punësimit, në të cilën Shoqëria paguan kontribute fikse në një entitet të veçantë, pa ndonjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar shumën shtesë. Detyrimet për kontributet për skemat pensionale, me një fond të përcaktuar kontributësh, si ajo e qeverisë Shqiptare janë njohur në pasqyrën e fitim ose humbjes kur detyrimi duhet të paguhet.

3.11 Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve janë llogaritur mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime kur shërbimi është kryer. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet nga përfitimet afatshkurtra, nëse Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të ofruara nga punonjësit dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

3.12 Përfitimet e punonjësve

Në përputhje me kushtet e Kodit të Punës, shoqëritë shqiptare janë të detyruara të paguajnë kontribute mujore për përfitime të daljes në pension të parashikuara për punonjësit e tyre të administruara nga skema me kontribute të përcaktuara të shtetit. Shoqëria nuk ka detyrime shtesë për punonjësit që largohen nga kompani apo të drejtën për kontributet pensionale.

3.13 Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi mbi të ardhurat i parapaguar

Aktivitet dhe detyrimet e të ardhurave të parapaguara për periudhën aktuale dhe të mëparshme maten me shumën që pritet të rikthehet ose të paguhet në organet tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore nga ku shumat e tatimit janë llogaritur janë ato që janë miratuar në datën e raportimit.

Tatimi mbi të ardhurat e shtyra

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, sipas ligjeve në fuqi. Një aktiv ose detyrim tatimor i shtyrë njihet nëse ekziston një e drejtë ligjore për kompensim në lidhje me tatimin mbi të ardhurat e parapaguara të mbledhura nga i njëjti autoritet.

3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.14 Provigjonet, pasivet dhe aktivet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të kaluara, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet me besueshmëri dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të detyrimit. Tarifat për ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme, qoftë pjesë e tarifës fillestare ose një tarife të veçantë, njihen si të ardhura kur shërbimet ofrohen. Kur tarifa e veçantë nuk mbulon koston e shërbimeve të vazhdueshme së bashku me një fitim të arsyeshëm, një pjesë e tarifës fillestare, e mjaftueshme për të mbuluar kostot e shërbimeve të vazhdueshme dhe për të siguruar një fitim të arsyeshëm për këto shërbime, shtyhet dhe njihet si e ardhur nga shërbimet e dhëna.

3.15 Adaptimi i standardeve të reja dhe atyre të rishikuara

Politikat kontabël për përgatitjen e pasqyrave financiare janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria në vitet 2016 dhe 2017, duke marrë në konsideratë ndryshimt në vijim të standardeve të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB):

- **Ndryshime në SNK 7 "Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare"**- Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat"** - njohjen e aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e porealizuara (efektive në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017),
- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** rezultat nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2017).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Shoqërisë.

3.16 Deklarime të reja kontabël

Disa standarte dhe interpretime të reja të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar duke filluar nga 1 janari 2018 e në vazhdim janë publikuar, dhe Shoqëria nuk i ka adaptuar ende:

- **SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- **SNRF 15 "Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët"** dhe ndryshimet e mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve" - Zbatimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiare" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentet Financiare" zbatohet për herën e parë).
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** - Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- **Ndryshimet në SNK 40 "Pronësia e investimit"** - Transferimet e Pronës së Investuar (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.16 Deklarime të reja kontabël (vazhdim)

- **Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)**" që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
